L I G J
Nr.8249, datë 7.10.1997

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7693, DATË 6.4.1993 "PËR URBANISTIKËN"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7693, datë 6.4.1993 "Për urbanistikën", në nenin 31, në formularin nr.3 "Kërkesë për leje ndërtimi", pas pikës 13 shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

"Miratimi nga organet e Inspektoratit Sanitar Shtetëror".

Neni 2

Në ligjin nr.7693, datë 6.4.1993, në nenin 41 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Këshillat e Rregullimit të Territorit në rrethe, Këshilli I Rregullimit të Territorit i Bashkisë së Tiranës dhe Këshilli I Rregullimit të Territorit të Republikës nuk miratojnë asnjë ndërtim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë funksionit, në territore publike të tilla si:

- terrene shoqërore;
- terrene të gjelbërta;
- terrene sportive;
- rrugë, sheshe, vendqendrime;

të përcaktuara dhe interpretuara në "Rregulloren e Urbanistikës" në pikat 103 deri në 106.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1948, datë 21.10.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani